



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.118/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada - Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, ALTERNATIVA, dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Gjakovë, për shkak të vendosjes së posterave në shtylla publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 06.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa ZL.Anr.118/2017 e datës 02.10.2017 e parashtruar nga subjekti politik ALTERNATIVA dega në Gjakovë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Gjakovë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

### A r s y e t i m

Me datën 02.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik ALTERNATIVA dega në Gjakovë, me të cilën pretendon se në shtylla elektrike në rrugë publike aktivist nga radhët e subjektit politik PDK kanë vendosur posterat e kandidatit Ramadan Hoti nga radhët e të njëjtit subjekt politik. Për më tepër ka shtuar se, këto veprime janë të ndaluara sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), pasi që mos respektimi i rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale, lidhur me vendosjen e posterave në objekte të përkohshme, ku theksohet vendosja e reklamave mund të bëhet vetëm në vendet e përcaktuara nga drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik PDK ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2014 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur *katër* (4) fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik PDK, në përgjigje në ankesë të datës 04.10.2017, thekson se lidhur me pretendimet në ankesë nga subjekti politik ALTERNATIVA, për shkak të vendosjes së posterëve të kandidatit Ramadan Hoti për kryetar të Komunës së Gjakovës nga radhët e subjektit të tyre politik, posedojnë kontratë për lejimin e vendosjes së posterëve në vendin e caktuar. PZAP-in e kanë njoftuar se, me kohë do ta dorëzojnë edhe kontratën e lartëcekur.

Në plotësimin e përgjigjes në ankesë i datës 04.10.2017 subjekti politik PDK ka theksuar se vendosja e posterave është bërë në bazë të marrëveshjes me kompanin “Selmans Network sh.p.k.” madje duke ia bashkangjitur në cilësi të provës kontratën për hapsira të marketingut i datës 21.09.2017.

Paneli, pasi që vlerësoj ankesën konstatoj se:


### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik PDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika b) të LZP-së, për arsye se vendosja e posterëve të kandidatit për kryetar komune të Gjakovës nga radhët e subjektit politik PDK në objektin privat është bërë me pëlqimin paraprak të pronarit të objektit, në bazë të kontratës mbi qeranë, për shfrytëzimin e hapsirave të marketingut e lidhur në mes të pronarit privat “Selmans Network” sh.p.k dhe Komunës së Gjakovës.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL. Anr.118/2017 më datën 06.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Rafet Haxhaj



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.